

**R E L A C I O N**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**  
**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN**  
**NR. 10 129, DATË 11. 5. 2009 “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË**  
**NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË**  
**ARRIHEN**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, propozohet në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë për riinxhinierimim e shërbimeve publike, ku pjesa më e madhe e tyre ofrohen “*on-line*”, në bazë të aksesit të shtetasve në portalin qeveritar unik “*e-albania*”.

Me zbatimin e reformës është shtuar gama e shërbimeve “*on-line*” për qytetarët, të cilëve krahas dokumenteve me nënshkrim elektronik të prodhohen me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010, u mundësohet dhe përftimi i dokumenteve të tjerë që më parë lëshoheshin nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut në sportel.

Në këtë mënyrë për shtetasit shqiptarë ofrohet një shërbim pa kosto, duke shmangur prezencën e nevojshme, kontaktin me nëpunësit e gjendjes civile në sportel, si dhe kohën fizike që më parë kërkohej për tërheqjen e dokumenteve në zyrat e gjendjes civile sipas organizimit të tyre, sipas amendimeve përkatëse.

Propozimet ligjore sipas këtij projektligji adresojnë gjithashtu zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, referuar ceshtjes kryesore që ka të bëjë me globalizimin, ku një pjesë e konsideruarshme e shtetasve shqiptarë zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor jashtë vendit.

Problematikat u adresohen shtetasve shqiptarë (i referohemi këtu kategorisë së personave me qëndrim të rregullt të pajisur me leje qëndrimi, apo që gëzojnë shtetësinë e huaj), të cilët në këto vende kryejnë dhe veprime të tjera, në mbrojtje të të drejtave të tyre personale, siç është psh. ndryshimi i përbërësve të gjendjes civile, emër, mbiemër, etj.

Për të përjasur këto problematika të krijuara me qëllimin ruajtjen e njëtrajshmërisë së identitetit të personit, lëvizjen e lirë të shtetasve është propozuar dhënia e zgjidhjes për pasqyrimin e ndryshimeve të kryera sipas ligjit të shtetit të huaj ku ata zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor dhe ekonomik.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË**

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2023.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji i propozuar synon të përmirësojë disa aspekte të zbatimit të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, që lidhen kryesisht me:

- njëtrajshmërinë e identitetit të tyre me qëllim shmangien e çdo pengese administrative që mundëson lëvizjen e lirë, duke pasqyruar dhe evidentuar në mënyrë të saktë përbërësit e gjendjes civile për të cilat shërbimi i gjendjes civile është përgjegjës.

Vlen të theksojmë se në shërbimin e gjendjes civile duhet të pasqyrohen vetëm ato përbërës që janë marrë në përputhje me ligjin e shtetit të huaj dhe jo ato që mund të jenë ndryshuar në mashtrim të tij, i referohemi këtu regjistrimeve që disa shtetas shqiptarë kanë patur në shtetin e huaj, duke deklaruar të pavërteta për sa i përket regjistrimit të tyre fillestar në Shqipëri, të cilat nuk mund të gjejnë pasqyrim;

- një prej veprimtarive kryesore që propozohet të përmirësohet ka të bëjë me rregullimin e procedurave për vendbanimin, regjistrimin e vendqendrimit të shtetasve të huaj, si dhe qartësimin e veprimeve që lidhen me dokumentimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës, i referohemi këtu fëmijëve që lindin të vdekur, si dhe në modalitete të mëtejshme që duhet të ndjekin nëpunësit e gjendjes civile në bashki / njësi administrative gjatë lidhjes së martesës, etj;

## **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Relacion për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”

Projektligji është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neneve 78 dhe 83, pika 1 dhe propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj përbëhet nga 26 nene dhe parashikon ndryshime në nenet 2, 4, 13, 14, 15, 16, 25, 33, 35, 38, 46, 57, 57/2, 67, 71 dhe 72, si dhe shfuqizon nenet 17, 18, 19, 20, 21, 21/1 dhe 22 të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar.

Neni 1, i projektligjit parashikon përkufizime për konceptin e “vendbanimit” dhe të “vendqëndrimit”, të cilët kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimeve në Kodin Civil.

Në nenin 2, të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 4 “Vlera juridike e të dhënave”, në linjë me zbatimin e reformës së inxhinierimit të ndërmarrë nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, me një shtrirje të gjerë në ofrimin e shërbimit të gjendjes civile, ku dokumentet kryesorë të gjendjes civile do të ofrohen vetëm elektronikisht.

Sipas formulimit në pikën 1 përcaktohet se të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile ose elektronikisht. Në zbatim të reformës së inxhinierimit, në këtë dispozitë është shtuar fjala “elektronikisht” duke prezantuar që në dispozitat hyrëse të ligjit mënyrën e vënies në dispozicion të të dhënave që në sajë të zhvillimeve informatike në më të shumtën e rasteve bëhet vetëm elektronikisht.

Sipas formulimit në pikën 2 është shtuar fjala “fizik”. Kjo dispozitë formulohet për të diferencuar mënyrën e ofrimit të shërbimit të gjendjes civile, tashmë të ofruar dhe elektronikisht siç përcaktohet që në pikën 1 të këtij neni. Lëshimi fizikisht i

dokumenteve do të vijojë deri në përmbylljen përfundimtare të procesit të inxhinierimit, të ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë.

Dispozita vijuese, sipas pikës 3 të këtij neni i referohet mënyrës së lëshimit elektronikisht të dokumenteve të gjendjes civile, respektivisht me nënshkrim elektronik si në rastin e Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) dhe me vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, në përputhje me legjislacionin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara. Kjo veprimtari është rregulluar në bazë të vendimit nr. 252, datë 29.4.2022 të Këshillit të Ministrave *“Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”*.

Në nenin 3, të projektligjit parashikohet emërtimi i dispozitës së paemërtuar, nenit 13 të tij *“Statusi i gjendjes civile”*, ku specifikohen sipas shkronjave a), b), c) dhe ç), statusi i gjendjes civile bazuar në parashikime të Kodit të Familjes, të miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003, të cilat respektivisht janë *“beqar/e”*, *“i/e martuar”*, *“i/e ve”* dhe *“i/e divorcuar”*.

Në nenin 4, të projektligjit parashikohet ndryshimi i dispozitës për nenin 14 të ligjit *“Deklarimi i vendbanimit”*, ku shprehimisht parashikohet detyrimi i shtetasve për deklarimin e adresës së çdo banese që kanë në pronësi brenda ose jashtë vendit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit duke zgjedhur ndër to vendbanimin e tij. Sipas këtij formulimi përcaktohet detyrimi i shtetasve për deklarimin e të gjitha adresave të banesave në pronësi të tyre, për të cilat duhet të përcaktojë vendbanimin e tij.

Sipas pikës 2 të dispozitës së propozuar përcaktohet se shërbimi i gjendjes civile do të ofrohet për shtetasit pasi të respektojnë detyrimin e mësipërm, duke parashikuar si kusht detyrimin për të deklaruar adresën e çdo banese në pronësi të tyre sipas ligjit për adresat.

Në nenin 5, të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 15 të ligjit *“Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit”*, të përbërë nga 6 pika.

Sipas formulimit në pikën 1, parashikohet se regjistrimi fillestar i vendbanimit sipas nenit 14 të këtij ligji, bëhet në zyrën e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial banesën e deklaruar si vendbanim, duke përcaktuar njëkohësisht se shtetasi nuk mund të deklarojë më shumë se një vendbanim

njëherazi. Formulimi sipas kësaj dispozite ka shkrirë në një të vetme parashikimet sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 15 të ligjit.

Sipas formulimit në pikën 2 të këtij neni parashikohet ndryshimi i vendbanimit që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga ardhja në këtë vendbanim, duke përcaktuar se i njëjti afat zbatohet edhe për deklarin e vendqëndrimit.

Në pikën 3 parashikohet se një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një familje tjetër, vetëm kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, parashikim që bëhej në nenin 17 të ligjit.

Në pikën 4 parashikohen veprimet konkrete që duhet të kryejë zyra e gjendjes civile pas deklarin të vendbanimit ose ndryshimit të tij pas paraqitjes nga shtetasi të dokumenteve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës.

Në pikën 5 parashikohet një hallkë kontrolli administrative e vlerësuar e nevojshme në mbarëvajtje të këtij procesi që konkretisht i referohet veprimeve që duhet të kryejnë strukturat komunitare të njësisë administrative në juridiksionin territorial të së cilës është vendbanimi në lidhje me përcaktimin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni për plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë dhe njëkohësisht të vërtetësisë së deklarinave të shtetasve lidhur me vendbanimin e tyre.

Ky proces, i parashikuar për t'u kontrolluar më mirë i shërben zgjidhjes së problematikave të evidentuara për ceshtjet e adresave të shtetasve, që në raste të caktuara mund të rezulojnë të pavërteta, duke mos pasqyruar lidhjen reale të individit me territorin ku i ofrohen shërbimet publike, të cilat në vijimësi njoftojnë zyrën e gjendjes civile nëse konstatohet mosplotësim i standardeve dhe deklarin i rremë. Në vijimësi zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative vijnë me refuzimin e kërkesës së shtetasit sipas arsytimit përkatës.

Sipas pikës 6 parashikohet se ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile për të nxjerrë mënyrën e aplikimit, rregullat për ndryshimin e vendbanimit dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit.

Sipas nenit 6 të ligjit parashikohet ndryshimi i nenit 16 të ligjit “E drejta për deklarin e vendbanimit”.

Në pikën 2 të nenit 6 të projektligjit, propozohet shtimi i procedurës së veçimit familjar. Sipas këtij propozimi qartësohen veprimet për përditësimin e përbërjes familjare duke iu referuar konceptit se anëtarë të një familje janë ata shtetas që jetojnë në një banesë. Në këtë mënyrë qartësohet gjithashtu se anëtarë të një familje nuk mund të jetojnë në banesa të ndryshme, pasi praktikisht rezultojnë të ndarë arsye për të cilën me qëllim rregullimin e kësaj marrëdhënie është propozuar kjo dispozitë, pra anëtarët e një familje nuk mund të jetojnë të ndarë.

Sipas nenit 7, të projektligjit parashikohet shfuqizimi i dispozitës sipas nenit 17 të ligjit.

Sipas nenit 8, nenit 9 dhe nenit 10 të projektligjit parashikohet shfuqizimi i dispozitave sipas neneve 18, 19 dhe 20 të ligjit që i referohen:

- regjistrimit të vendbanimit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë;
- afatit të deklaramentit të ndryshimit të vendbanimit për arsye pune ose arsimimi;
- deklaramentit të vendbanimit pranë punëdhënësit apo institucionit arsimor;

Sipas nenit 11 të projektligjit parashikohen ndryshime në nenin 21 të ligjit “Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi”, konkretisht në emërtimin e dispozitës që propozohet të ndryshojë në “Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj, personave pa shtetësi, i cili bëhet sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për të huajt. Në dispozitën e mëparshme për të huajt dhe personat pa shtetësi ndeshim konceptin e vendbanimit dhe jo të vendqëndrimit që rregullohet sipas këtij projektligji.

Sipas nenit 12, të projektligjit parashikohet shfuqizimi i dispozitës, nenit 21/1 të ligjit.

Sipas nenit 13, të projektligjit parashikohet shfuqizimi i dispozitës, nenit 22 të ligjit.

Sipas nenit 14 të projektligjit parashikohen në mënyrë të detajuar ndryshimet në nenin 25 të tij “Llojet dhe vecoritë e përgjithshme të dokumenteve”. Sipas formulimit në pikën 1, përfshihet dhe koncepti i vendqëndrimit i përcaktuar në këtë projektligj sipas Kodit Civil, njëkohësisht duke përforcuar mënyrën e ofrimit elektronikisht të këtij shërbimi si një risi e aplikimit, zhvillimeve të reformave qeveritare në ofrimin elektronikisht të shërbimeve.

Në pikën 2 të kësaj dispozite parashikohet se dokumentet bazë që harton, mban dhe administron shërbimi i gjendjes civile, në mënyrë specifike janë akti i lindjes, akti i martesës, akti i vdekjes, vendimet e komisionit kombëtar për ndryshimin e emrit / mbiemrit, vendimet për korigjim si gabim material të drejtorit të përgjithshëm, procesvebalet për bashkim dhe vecim familjar dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile.

Në pikën 3 të kësaj dispozite parashikohen dokumentet bazë që harton dhe lëshon shërbimi i gjendjes civile, që janë përgjigje ndaj kërkesave të të interesuarve dhe certifikatat nga dokumentet bazë që harton dhe lëshon shërbimi i gjendjes civile për përdorim brenda dhe nga autoritetet e huaja.

Në pikën 4 parashikohet se llojet, forma, elementet përbërëse si dhe mënyra e hartimit, mbajtjes, administrimit dhe lëshimit të dokumenteve bazë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Në nenin 15 të projektligjit parashikohen ndryshimet në nenin 33, pika 1, ku fjalët “dokumenti unik shtetëror”, zëvendësohen me fjalët “baza e vetme e të dhënave shtetërore”.

Në nenin 16 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 35 “Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar”, sipas përcaktimeve për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi me qëndrim të përkohshëm / të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 17 të projektligjit “Dokumentet bazë të lindjes”, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Kur në kohën e regjistrimit të lindjes fëmija nuk është i gjallë, nëpunësi i gjendjes civile regjistron lindjen, sipas rasteve:

a. Në rast se fëmija ka lindur e gjallë, fëmija regjistrohet me emër në aktin e lindjes dhe më pas mbahet akti i vdekjes.

b. Në rast se fëmija ka lindur i vdekur, hartohet akti i lindjes pa emër dhe më pas mbahet akti i vdekjes.

Në këtë dispozitë, sipas pikës 5 parashikohet gjithashtu se ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të nxjerrë rregullat për veprimet, që do të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile për regjistrimin e fëmijëve që lindin të vdekur, si të dhëna të cilat gjithashtu duhet të dokumentohen nga shërbimi i gjendjes civile për efekte statistikore, kërkuar dhe nga INSTAT.

Në nenin 18 të projektligjit parashikohet shtimi i togfjalëshit “sipas rregullave të miratuara me udhëzim nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile”, parashikuar si njëmekanizëm kontrolli, në vijim të opinionit të 5-të për Shqipërinë të Komitetit Këshillues për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, të miratuar më datë 06.06.2023, për ceshtje të përgjegjësisë së gjendjes civile të trajtuara në këtë raport në formën e rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë si bazë për rezolutën që do të miratohet nga Komiteti i Ministrave, lidhur me zbatimin e Konventës Kuadër nga Shqipëria.

Sipas pikës 63 të raportit Komiteti Këshillues, u bën thirrje autoriteteve të vazhdojnë të punojnë për uljen e rrezikut të pashtetësisë ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare. Sipas këtij raporti parashikohet në mënyrë specifike se: *“Autoritetet duhet të ndërmarrin një rol më aktiv në hetimin dhe adresimin e ndikimit të martesave fiktive, siç edhe përmendet në pikën 20 të tij, në mënyrë të veçantë ndaj grave dhe fëmijëve që u përkasin pakicave kombëtare, duke siguruar ndaj tyre mbështetjen e duhur sociale, ligjore dhe financiare, për të siguruar se kuadri ligjor për martesat është zbatuar në mënyrën e duhur në një mënyrë jo diskriminuese dhe për të rritur ndërgjegjësimin e rrezikut të këtij procesi ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare”*.

Në nenin 19 të projektligjit, pas pikës 2, të nenit 57, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: “Ngarkohet ministri që mbulon gjendjen civile në mbështetje të Kodit të Familjes, të nenit 46 të këtij ligji, të nxjerrë rregullat për procedurën e lidhjes së martesës dhe dokumentacionit që duhet të sigurojë shërbimi i gjendjes civile për lidhjen e martesës dhe ndryshimin e mbiemrit”.

Kjo hallkë verifikimi sipas dispozitës së propozuar parashikohet të ndërmerret në mbështetje të raportit, sipas orientimeve të dhëna për ndërmarrjen e një roli më aktiv në hetimin dhe adresimin e fenomenit të ndeshur të martesave fiktive, që duhet të mbetet në qendër të veprimtarisë së shërbimit të gjendjes civile.

Në nenin 20 të projektligjit “Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës”, pas shkronjës “e”, është propozuar shtimi i shkronjës “ë”, me përmbajtjen “vendimin administrativ lëshuar nga autoritetet e huaja, ku shtetasi shqiptar ka vendbanimin apo vendqendrimin”.

Ky formulim shtohet për të qartësuar se ndryshimet e përbërësve të gjendjes civile kryhen jo vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor, pra nuk shqyrtohen vetëm



gjyqësisht, por edhe administrativisht sipas legjislacionit në fuqi në shtetet e huaja, përcaktim që nuk parashikohej në dispozitat aktuale të ligjit.

Në nenin 21 të projektligjit propozohet shtimi i detyrave të nëpunësve të zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, sipas shkronjës “ë”, me këtë përmbajtje: “lëshojnë vërtetim ku konfirmohet fakti që kemi të bëjmë me të njëjtin person kur vërejnë se nga një transkriptim në tjetrin për shtetasit shqiptarë ka gabime në një ose më shumë përbërës të gjendjes civile”. Kjo detyrë e nëpunësve të arkivave të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut parashikohet si një detyrë specifike për t’u përmbushur në plotësim të nevojave administrative të shtetasve, në dhënien e shpjegimeve të nevojshme për të dhënat e gjendjes civile dhe transkriptimin e tyre.

Në nenin 22 të projektligjit në mënyrë specifike parashikohen detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, për të cilët do të kryejnë veprime të njëllojta si nëpunësit e tjerë të shërbimit të gjendjes civile brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Sipas formulimit në pikën 2 të nenit 71, këta nëpunës përpara fillimit të detyrës kanë detyrimin të trajtohen si nëpunësit e tjerë të gjendjes civile.

Sipas formulimit në pikën 3 të këtij neni në projektligj parashikohet se këta nëpunës administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010 për shtetasit shqiptarë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

Pika 4 e këtij neni parashikon nxjerrjen e rregullave të administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë mbi të cilët nëpunësit e shërbimit në postet konsullore kryejnë veprime të gjendjes civile.

Për nëpunësit konsullorë këto detyra shtohen me qëllim ofrimin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të shpejtë shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Në nenin 23 të projektligjit është propozuar trajtimi administrativ i ankesave në shërbimin e gjendjes civile. Në pikën 1 të tij respektivisht parashikohet se nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile është i detyruar të përgjigjet në mënyrë shkresore ose elektronike për çdo kërkesë të personave të interesuar për shërbimet e gjendjes civile.

Në këtë dispozitë parashikohet dhe komunikimi elektronik me shtetasit, kërkesave të adresuara nëpërmjet *e-mail*-it, për të cilat nëpunësi i gjendjes civile gjithashtu ka detyrimin të përgjigjet po nëpërmjet komunikimit elektronik, sipas adresës së tij zyrtare, si nëpunës i administratës shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Sipas pikës 2 të nenit parashikohet se kundër refuzimit të nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile apo aktit të tij mund të paraqitet ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, i cili sipas formulimit në pikën 3 duhet të paraqitet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e aktit të nëpunësit të gjendjes civile ose moskthimit të përgjigjes prej tij. Gjithashtu sipas formulimit në këtë dispozitë parashikohet se shqyrtimi i këtij ankimi administrativ të paraqitur pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Në pikën 4 të këtij neni parashikohet se vendimi i nxjerrë në bazë të ankimit administrativ është i detyrueshëm për zbatim nga nëpunësi përkatës i shërbimit të gjendjes civile kompetent për kryerjen e veprimit administrativ.

Në pikën 5 parashikohet se kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Në nenin 24 të projektligjit parashikohen heqja e kundravajtjeve administrative nga dispozitat e shfuqizuara, respektivisht nenin 19 pikat dhe 2, në nenin 20, pika 1 dhe në nenin 18, pikat 2 dhe 3 dhe në nenin 20, pika 2.

Në nenin 25 të projektligjit është parashkuar miratimi i akteve nënligjore, respektivisht në zbatim të pikës 6, të nenit 5, pikës 5 të nenit 17, në nenin 18 dhe 19 të këtij ligji dhe të pikës 4 të nenit 71 të këtij projekt ligji, si vijon:

- a. udhëzim i Ministrit të Brendshëm lidhur me mënyrën e aplikimit, rregullat për ndryshimin e vendbanimit dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit;
  
- b. udhëzim i Ministrit të Brendshëm lidhur me rregullat për veprimet, që do të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile për regjistrimin e fëmijëve që lindin të vdekur;

- c. udhëzim i Ministrit të Brendshëm lidhur me rregullat për procedurën e mbajtjes së martesës dhe dokumentacionit që duhet të sigurojë shërbimi i gjendjes civile për lidhjen e martesës dhe ndryshimin e mbiemrit; dhe
- ç. udhëzim i përbashkët i Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme “Për rregullat e administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, për të cilët kryhen veprimet nga nëpunësit konsullorë”.

Në nenin 26, është parashikuar hyrja në fuqi e këtij projektligji.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Brendshme.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI**

**Taulant BALLA**